



# KONKURS PËR BURSA

## FONDACIONI I SHKENCËS DHE KULTURËS "DITURIA"

Fondacioni i Shkencës dhe Kulturës "DITURIA" duke u nisur nga parimi i përkrahjes dhe avancimit të dijes shpall konkursin e hapur të bursave për vitin akademik 2011/2012 për studentët e suksesshëm të shpërndarë në të gjitha universitetet e R. Maqedonisë.

### DHËNIA E BURSAVE PËR STUDENTË TË TALENTUAR

#### KUSHTET PËR NDARJE TË BURSAVE

- I. Të drejtën e bursës e kanë kandidatët që mësojnë në Universitetet dhe fakultetet e RM-së.
- II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet vijuese:
  - a) Studentët e vitit II, III, IV dhe V gjatë viteve të mëparshme duhet të kenë arritur sukses me notë mesatare mbi 8 (tetë).
  - b) Të mos kenë përsëritur gjatë vitit arsimorë;
  - c) Të mos jenë shfrytëzues të bursave ose kredive nga institucionet apo ndërmarrjet tjera;

### DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARJE NË KONKURSIN PËR BURSA

1. CV (biografi)
2. Kopje të indeksit (*dy faqet e para – faqen e fotografisë dhe faqen ku është regjistruar semestri i fundit*).
3. Vërtetim i notave ku mund të shihet nota mesatare (Në fakultetet që ky dokument është me pagesë, ata student do ti sjellin vetëm fotokopjet e notave që i kanë marrë në indeksat e tyre).
4. Për studentët e vitit I vërtetim për semestrin e rregullt të regjistruar për vitin akademik 2011/2012, fotokopje të provimit të maturës shtetërore si dhe fotokopje të dëftesës së vitit të katërt (diplomës).
5. Për studentët e vitit II, III, IV, V dhe VI vërtetim për semestrin e rregullt të regjistruar për vitin akademik 2011/2012, si dhe vërtetim me numrin e provimeve të parapara dhe të dhëna nga vitet e mëparshme;
6. Vërtetim për të ardhurat e realizuara të anëtarëve të punësuar të familjes (për anëtarët e pensionuar - fletëpagesë pensioni, për ata që marrin ndihmë sociale – fletëpagesën e ndihmës sociale, për ata që nuk punojnë - vërtetim nga Enti i Punësimit se nuk janë në marrëdhënie pune);
7. Kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit.

## **VLERA E BURSAVE**

Vlera e bursës për studentët për vitin akademik 2011/2012 do të jetë :

**\* 6.000,00 denarë për çdo muaj.**

Bursat ndahen për aq vite shkollore, gjegjësisht semestra, sa janë paraparë me planet mësimore, përkatësisht me aktet e përgjithshme të institucioneve arsimore përkatëse. Bursistëve do t'u ndahet bursë 9 muaj në vit (aq sa zgjatë viti akademik shkollor), ndërsa pagesa do të bëhet çdo muaj.

Kandidatëve që u është ndarë bursa, e kanë të drejtën e shfrytëzimit të bursës nëse gjatë shkollimit e ruajnë suksesin e nevojshëm dhe kushtet e parapara me marrëveshjen për shfrytëzimin e bursës.

## **IV. VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE**

Fletëparaqitjet dhe dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në zyrat e **Fondacionit të Shkencës dhe Kulturës "Dituria", Bulevardi vëll. Gjinoski nu. 156 në Gostivar.**

**Fletëparaqitjet dorëzohen në afatet vijuese :**

\* për student prej vitit të I deri në vitin e VI: prej **17.10.2011 deri më 31.10.2011.**

Gjatë dorëzimit të dokumentacionit për bursë studentore, kandidatët duhet të kenë me vete letërnjoftimin dhe indeksin. Krahas dokumenteve të lartpërmendura, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe kopje të letërnjoftimit.

Për rezultatet e konkursit, studentët do të informohen përmes web adresës sonë **www.dituria.org.mk** si dhe në zyrat e Fondacionit të Shkencës dhe Kulturës "Dituria".

## **SQARIM**

1. Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati.
2. Dokumentet e kandidatëve që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, gjegjësisht që nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të merren në shqyrtim.
3. Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet prapë, pra mbetet në arkivin e Fondacionit.
4. Çdo kandidat që do të konkurrojë, duhet të marrë dëshmi (numër protokolli) se i ka dorëzuar dokumentet.
5. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i futur në zarf.
6. Fletëparaqitjet dhe deklaratat aplikuesit do t'i marrin në zyrën e Fondacionit

<http://www.dituria.org.mk/>